



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE ARKIV/PROTOKOLLIT

Tiranë, më 10.10. 2024

Lënda : Njoftim për shpallje konkursi për 3(tre) pozicione pune për personel akademik me kohë të pjesshme në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes

DREJTORISË SË ZHVILLIMIT TË PROGRAMEVE DHE DIXHITALIZIMIT TË SHËRBIMEVE AKADEMIKO-SHKENCORE

KËTU

Universiteti i Sporteve të Tiranës, bazuar në Ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e UST-së, si dhe në vendimin e Rektorit të UST-së, shpall kriteret për 3 (tre) vende pune për personel akademik me kohë të pjesshme, 1 (një) personel akademik kategoria “**Lektor**” dhe 2(dy) personel akademik kategoria “**Asistent Lektor**”, pranë Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

Shpalljen në Web-in [http:// www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) të procedurave të aplikimit për personelin akademik me kohë të pjesshme në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes është si më poshtë :

I. DEPARTAMENTI I EDUKIMIT DHE SHËNDETIT

1 (një) Lektor.

Lënda : “**Fiziologji e Aplikura në Edukimin Fizik dhe Shëndet**”

Moduli : “**Edukim i të Ushqyerit**”, (Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor, viti I-rë, semestri i I-rë).

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për “**Lektor**” në Lëndën: “**Fiziologji e Aplikura në Edukimin Fizik dhe Shëndet**”, si dhe në Modulin : “**Edukim i të Ushqyerit**”, janë si më poshtë:

Kritere të përgjithshme:

1. Kandidati duhet të mbajë të paktën gradën shkencore “Doktor”.
 - a. (Grada shkencore e mbrojtur në institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
2. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës.

3. Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë brenda apo jashtë vendit.
4. Të ketë veprimtari kërkimore–shkencore dhe botime në disiplinën përkatëse.
5. Të plotësojë kriteret e propozuara nga njësia bazë përkatëse.
6. Të përmbushë kriteret që përcaktohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
7. Të mos ketë prishur apo cënuar imazhin e UST-së.
8. Dëshmi penaliteti/formular i vetëdeklarimit.

Kritere specifike:

1. Kandidati të ketë diplomë në fushën përkatëse.
2. Të ketë kryer aktivitete shkencore si: referime, botime brenda dhe jashtë vendit që kanë lidhje me fushën e studimit të kërkuar.
3. Vlerësohen kualifikime të ndryshme në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së studimit.

Kritere preferenciale:

1. Kanë preferencë kandidatët që kanë përvojë akademike në fushën përkatëse.
2. Preferohen kandidatët që kanë bashkëpunuar më parë me UST.

II. DEPARTAMENTI I SPORTEVE KOLEKTIVE

2 (dy) Asistent Lektorë,
Lënda : “**Gjmnastikë**”

1(një) Asistent Lektor (Mashkull)
Moduli : “**Gjmnastikë Artistike**”, (Bachelor).
Moduli : “**Akrobaci**”, (Bachelor).

1(një) Asistent Lektor (Femër)
Moduli : “**Gjmnastikë Artistike**”, (Bachelor).
Moduli : “**Aerobi**”, (Bachelor).

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për “**Asistent Lektorë**” në Lëndën: “**Gjmnastikë**”, si dhe në Modulet : “**Gjmnastikë Artistike**”, “**Akrobaci**” dhe “**Aerobi**”, janë si më poshtë:

Kritere të përgjithshme:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës.
2. Kandidati që konkuron për pozicionin e punës “As/Lektor” duhet të zotërojë së paku diplomë të ciklit të dytë, Master i Shkencave ose ekuivalent me të, në fushën e kërkuar. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njëhësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
3. Kandidati duhet të ketë notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave mbi 8 (tetë).
4. Kandidati duhet të zotërojë me dëshmi së paku një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht).
5. Të mos ketë cënuar ose prishur imazhin e UST-së.

6. Dëshmi Penaliteti/formular i vetëdeklarimit.

Kritere specifike:

4. Kandidati të ketë diplomë në fushën përkatëse.
5. Të ketë kryer aktivitete shkencore si: referime, botime brenda dhe jashtë vendit që kanë lidhje me fushën e studimit të kërkuar.
6. Vlerësohen kualifikime të ndryshme në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së studimit.

Kritere preferenciale:

3. Preferohen kandidatët që kanë përvojë akademike në fushën përkatëse.
4. Preferohen kandidatë që kanë bashkëpunuar më parë me UST.

2 Kandidatët që do të aplikojnë për këto vende pune duhet të dorëzojnë këto dokumenta:

- a) Formular aplikimi;
- b) Letër motivimi dhe shprehje interesi për lëndën/modulin që kandidati aplikon.
- c) Një kopje jetëshkrimi i fokusuar në eksperiencat në mësimdhënie dhe botime shkencore;
- d) Kopje e noterizuar e diplomës/ve dhe listës/ve të notave. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
- e) Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm original ose të noterizuar, sipas plotësimit të kritereve të shpallura;
- f) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- g) Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti/ formulari i vetëdeklarimit);
- h) Vërtetim nga qendra e punës për t'u angazhuar si pedagog me kohë të pjesshme në institucionin tonë. (n.q.s është i punësuar e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon. (dorëzohet nëse shpallet fitues)
- i) Librezë shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).

3 Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit

Dokumentacioni i plotësuar sipas kritereve të shpallura të konkurrimit në njoftimin publik, bëhet me postë sipas afateve të shpallura:

- Vetëm paketat e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti dhe Departamenti ku konkuron.
- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

IV. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët

- Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 5 (pesë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit. Kandidati duhet të plotësojë dokumentacionin e kërkuar

brenda 5 (pesë) ditëve nga data e publikimit të njoftimit dhe e dorëzon atë të mbyllur në zarf me rrugë postare.

- V. Të pranohet si kandidaturë qoftë dhe kur paraqitet vetëm një dosje, me kusht që kandidati të plotësojë kriteret.
- VI. Deri në datën 18.10.2024, të ngrihet pranë Departamentit, Komisioni ad-hoc, i cili brenda datës 22.10.2024 duhet të vlerësojë dosjet e paraqitura. Pas shpalljes së listës me kandidatët vlerësues, afati i pritjes së ankesave është 2 (dy) ditë.
- VII. Departamenti përkatës në bashkëpunim me Komisionin ad-hoc është përgjegjës për ruajtjen dhe arkivimin e dosjeve si dhe të kontratave të lidhura me kandidatët fitues.
- VIII. Dekanati i FSHL-së, përcjell listën përfundimtare brenda datës 25.10.2024, për miratim në Rektorat.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE ARKIV/PROTOKOLLIT